

VENDIM
Nr. 614, datë 29.7.2020

PËR SHEMBJEN E KATËR OBJEKTEVE TË DHËNA ME QIRA, ME KONTRATËN E QIRASË NR. 1998 REP, NR. 767 KOL, DATË 19.4.2019, ME TARIFËN 1 EURO/KONTRATA, TË LIDHUR NDËRMJET MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË, SI QIRADHËNËS, DHE FONDACIONIT “FUNDJAVË NDRYSHE”, SI QIRAMARRËS, NË ADMINISTRIM TË NDËRMARRJES INDUSTRIALE NR. 1, TIRANË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe në vijim të pikës 7, të kreut VIII, të vendimit nr. 54, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontratave të tjera të pasurisë shtetërore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shembjen e katër objekteve me emërtimet: objekti nr. 8 “Godinë, ish-ndërtesa gr. shkencor”, objekti nr. 10 “Depo”, objekti nr. 11 “Godinë, ish-optika e re” dhe objekti nr. 12 “Ish-magazinë rikupero”, pjesë përbërëse e pronës me nr. 109, me emërtim “Sh.a. riparim artilerie”, të dhëna me qira me kontratën e qirasë nr. 1998 rep., nr. 767 kol., datë 19.4.2019, me tarifën 1 euro/kontrata, të lidhur ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si qiradhënës, dhe fondacionit “Fundjavë ndryshe”, si qiramarrës, miratuar me vendimin nr. 118, datë 13.3.2019, të Këshillit të Ministrave, me vendndodhje në Brar, Tiranë, me nr. pasurie 969/12, zona kadastrale 1263, në administrim të Ndërmarrjes Industriale nr. 1, Tiranë, sipas tabelës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ndërmarrja Industriale nr. 1, Tiranë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

Tabela nr. 1

Lista e objekteve në administrim të Ndërmarrjes Industriale nr. 1, Tiranë, që do të shemben

Nr.	Njësia që e administron	Nr. pronës/vendndodhja	Emërtimi i ndërtesës	Sipërfaqja (m²)	Vlera e 3 objekteve (lekë)
1	Ndërmarrja Industriale nr. 1	nr. 8, Brar, Tiranë	Objekti nr. 8 – Godinë, ish-ndërtesa gr. shkencor	163.62	202.68
2	Ndërmarrja Industriale nr. 1	nr. 10, Brar, Tiranë	Objekti nr. 10 - Depo	144	332.301
3	Ndërmarrja Industriale nr. 1	nr. 11, Brar, Tiranë	Objekti nr. 11 – Godinë, ish-optika e re	1036.85	1.681.047
4	Ndërmarrja Industriale nr. 1	nr. 12, Brar, Tiranë	Objekti nr. 12 - Ish-magazinë rikupero	981.26	1.870.579

	SHUMA				4.086.607
--	-------	--	--	--	-----------